



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, më 2 qershor Gjykatësi i Vetëm vendosi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit. Të katër të pandehurit e tjerë në këtë çështje po mbrohen të gjithë në gjendje të lirë. Bashkim Smakaj, Isni Kilaj dhe Fadil Fazliu u liruan përkohësisht, ndërsa Hajredin Kuçi nuk ka qenë asnjëherë në paraburgim në kuadër të këtij procesi.

Në vendimin për paraburgimin e z. Thaçi, Gjykatësi i Vetëm rikujtoi dyshimin e bazuar për përpjekje të shumta nga z. Thaçi për të penguar procesin në gjykimin e tij për krime lufte, parë edhe në kontekstin e atmosferës së përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë, në kuadër të proceseve gjyqësore lidhur me pretendime kundër ish-anëtarëve të UÇK-së. Gjykatësi shqyrtoi gjithashtu edhe nëse, dhe si, ndikon faza aktuale e gjykimit, që po i afrohet përfundimit, në vendimin mbi paraburgimin. Ai konstatoi se, megjithëse faza e paraqitjes së provave do të mbyllet së shpejti, ende ekziston rreziku i hakmarrjes ose i orvatjeve për të ndikuar ndaj dëshmitarëve të ndjeshëm.

Përveçse rishikoi domosdoshmërinë e paraburgimit, Gjykatësi i Vetëm shqyrtoi edhe nëse paraburgimi i z. Thaçi mund të konsiderohet ende i arsyeshëm dhe proporcional, dhe e konfirmoi këtë konstatim. Ndër faktorë të tjerë, ai vuri në dukje se dënimi i mundshëm sipas ligjit për akuzat kundër z. Thaçi është shumë më i lartë se ai i të bashkëzuarve të tij dhe se roli udhëheqës i pretenduar i z. Thaçi në orvatjet për pengim të drejtësisë përbën një shkallë më të lartë rreziku.

Në përputhje me kornizën ligjore të DHSK-së, gjykatësi do të rishikojë përsëri paraburgimin e z. Thaçi pas dy muajsh, për të vlerësuar nëse ai vazhdon të jetë i përligjur dhe proporcional.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 3 qershor u bë publik një vendim i mëparshëm i Kryetares së DHSK-së me të cilin caktoi një panel të apelit për të vendosur lidhur me një apel të Mbrojtjes së Thaçit kundër vendimit të Gjykatësit të Vetëm për pranimin e raporteve ndërkombëtare.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 28 maj, Paneli i Apelit vendosi në lidhje me apelin e Rexhep Selimit ndaj një vendimi të Trupit Gjyqësor të lëshuar në mars, me të cilin i kishte refuzuar lirinë e përkohshme. Paneli i Apelit e hodhi poshtë apelin. Ndër arsytet e paraqitura për apel nga Mbrojtja ishte ankesa se një vlerësim konfidencial i Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve të Zyrës Administrative, që palët nuk e kishin në dispozicion në atë kohë, kishte qenë faktor i konsiderueshëm në vendimin e Trupit Gjyqësor për vazhdimin e paraburgimit.





Paneli i Apelit konstatoi se Trupi Gjykses ishte mbështetur në masë të vogël në këtë dokument dhe se ai nuk kishte qenë vendimtar për konstatimin se rreziku i pengimit nga z. Selimi vazhdon të ekzistojë. Gjykatësit theksuan gjithashtu se Mbrojtja kishte qasje në versionin e redaktuar të vlerësimit përpara se të dorëzonte apelin dhe, rrjedhimisht, mund të kishte paraqitur pretendime konkrete për ndonjë dëm të shkaktuar prej tij.

Pas vendimit të Apelit, Trupi Gjykses u caktoi palëve afate për dorëzimin e parashtrimeve të reja në kuadër të rishikimit të përdymuajshëm të paraburgimit të z. Selimi nga Trupi Gjykses. Z. Selimi kishte hequr dorë nga e drejta për rishikimin e përdymuajshëm të paraburgimit deri në vendimin mbi apelin.

Në çështjen e Pjetër Shalës, Paneli i Gjykatës Supreme miratoi kërkesën e Mbrojtjes për zgjatje me pesë ditë të afatit për dorëzimin e kundërpërgjigjes ndaj përgjigjes së Mbrojtjes së Viktimave në lidhje me një kërkesë referuese që z. Shala i paraqiti Dhomës së Gjykatës Supreme lidhur me Urdhrin e Zhdëmtimit të lëshuar në çështjen e tij. Afati i ri për dorëzimin e kundërpërgjigjes është data 10 qershor.

